




MODELI 3D I QYTETIT TË TEPELENËS
PËRFTUAR NGA TEKNOLOGJIA UAV

Identifikimi Automatik i Ndërtesave përmes Teknologjive të Avancuara dhe Inteligjencës Artificiale (AI)

Në kuadër të procesit të digjitalizimit dhe modernizimit të të dhënave gjeohapësinore, ASIG ka vijuar me identifikimin automatik të ndërtesave në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Nëpërmjet përdorimit të modeleve AI (Deep Learning) të krijuara nga ekspertët e ASIG, janë identifikuar ndërtesat për 44 Njësi të Vetëqeverisjes Vendore (NJQV), ndërsa identifikimi automatik është në proces për 17 NJQV-të e tjera.

Ky proces tregon përkushtimin e vazhdueshëm të ASIG për të sjellë teknologji inovative që rrisin saktësinë, efikasitetin dhe aksesueshmërinë e të dhënave gjeohapësinore, duke kontribuar në një menaxhim më të mirë të territorit dhe zhvillimin e planifikimit urban në të gjithë vendin.



Ndërtesat e identifikuara automatikisht në 44 NJQV të Republikës së Shqipërisë



Gjurmët e ndërtesave të përfthuara nga dedektimi automatik Durrës 2025


Publikime në Gjeoportalin Kombëtar

ASIG, në cilësinë e autoritetit publik përgjegjës për temën “Përcaktimi i kornizës referuese gjeodezike dhe kontrolli gjeodezik”, ka publikuar dhe përditësuar në Gjeoportalin Kombëtar shtresat e Kornizës Referuese Gjeodezike të Shqipërisë (KRGJSH), konform Standardit Shtetëror për Specifikimet Teknike të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri.


Publikimi i shtresës “Rrjeti Shtetëror i Nivelimit”

ASIG ka publikuar në Gjeoportalin Kombëtar shtresën “Rrjeti Shtetëror i Nivelimit”, e cila do të mundësojë kontrollin dhe vlerësimin e saktësisë së gjeoidit gravimetrik, duke shërbyer, si baza për referencën gjeodezike vertikale të re dhe për përcaktimin e lartësive ortometrike në territorin e Republikës së Shqipërisë. Rrjeti është projektuar në dy rinde, ku për rendin e parë të këtij rrjeti janë ndërtuar dy linja nivelimi me gjatësi totale prej 125.24 km, si më poshtë:

- Linja Tiranë–Durrës: 58.75 km (26 repera);
- Linja Vorë–Shëngjin: 66.49 km (25 repera).



Përditësimi i shtresës “Rrjeti Shtetëror Gravimetrik i Republikës së Shqipërisë”



ASIG ka përditësuar në Gjeoportalin Kombëtar shtresën “Rrjeti Shtetëror Gravimetrik i Republikës së Shqipërisë”, e cila përfshin informacion gjeohapësinor për:

1. Rrjetin Shtetëror Gravimetrik të Rendit Zero (3 pika);
2. Rrjetin Shtetëror Gravimetrik të Rendit të Parë (42 pika);
3. Rrjetin Gravimetrik të Rendit të Dytë (338 pika);
4. Rrjetin Gravimetrik të Rendit të Tretë (772 pika).

Pikat gravimetrike absolute të rendit zero (Shkodër, Tiranë, Sarandë) dhe 42 pikat e rrjetit gravimetrik relativ të rendit të parë përbëjnë Datumin Gravimetrik Shqiptar.

Rilevim me teknologjinë UAV në zonën e Tepelenës

ASIG ka kryer një rilevim fotogrametrik të zonës urbane të qytetit të Tepelenës me teknologjinë UAV (Unmanned Aerial Vehicle). Ky rilevim mbulon një sipërfaqe prej 3.87 km² me rezolucion 4 cm, gjë që garanton cilësi të lartë dhe detaje të imta për analizat gjeohapësinore në mjedisin urban. Në vijim të procesit, u krye edhe një mision fotografimi me metodën oblique, i cili mundëson imazhe me kënde të ndryshme, duke ofruar pamje reale dhe detaje të sakta të terrenit dhe objekteve.

Produktet e ofruara përfshijnë:

- Ortofoto;
- DSM (Modeli Digjital i Sipërfaqes);
- DTM (Modeli Digjital i Terrenit);
- Izoipse.



Izoipset, Tepelenë


Realizimi i fotografimit 360° të gjeoreferencuar, të rrjetit rrugor kombëtar

Me qëllim krijimin e fotografive panoramike të gjeoreferencuara të akseve rrugore kombëtare me teknologjinë e avancuar me kamera Street View 360°, ASIG ka realizuar fotografimin dhe publikimin në Gjeoportalin Kombëtar të rrugëve urbane të qytetit të Fierit. Gjatësia e aksit të mbuluar me fotografi 360° është 156 km. Ky informacion vizual i detajuar shërben si mjet mbështetës për planifikimin territorial, menaxhimin e infrastrukturës dhe monitorimin e zhvillimeve urbane.



Rrugë Urbanë, Fier

Zgjerimi i Hartës Bazë – Zona Muriqan-Obot në Shkodër




ASIG në cilësinë e Autoritetit Përgjegjës për temën “Harta Bazë”, si dhe në kuadër të zgjerimit të projektit fillestar të Hartës Bazë të shkallës 1:2000, ka vijuar me krijimin e hartës topografike digjitale për zonën rurale Muriqan-Obot në Bashkinë Shkodër. Krijimi i kësaj harte është realizuar me anë të teknologjisë së rilevimit fotogrametrik 3D, duke mbuluar një sipërfaqe të rilevuar prej 17.8 km². Numri i shtresave të përdorura për këto rilevime fotogrametrike 3D arrin në 180.

TRAJNIME PËR GJEONFORMACIONIN

Në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitutional dhe nismës për rritjen e kapaciteteve në menaxhimin dhe përdorimin e informacionit gjeohapësinor, ASIG zhvilloi në datat 27–28 tetor 2025 një trajnim të dedikuar për stafin teknik të Bashkisë Himarë.

Gjatë trajnimit u ofrua asistencë teknike për ndërtimin e bazës së të dhënave gjeohapësinore në përputhje me standardet kombëtare, si dhe u trajtuan funksionalitetet e Gjeoportalit Kombëtar, përfshirë aksesin dhe vizualizimin e hartave ortofoto dhe shtresave tematike që lidhen me infrastrukturën, ndërtimet, zonat e mbrojtura dhe elemente të tjera të territorit.

Këto iniciativa synojnë forcimin e kapaciteteve institucionale dhe përmirësimin e cilësisë dhe aksesueshmërisë së të dhënave gjeohapësinore, në përputhje me kuadrin ligjor dhe standardet e administrimit të informacionit gjeohapësinor.



PJESËMARRJE NË AKTIVITETE


Workshop i TAIX në bashkëpunim me ASIG mbi zbatimin e Direktivës INSPIRE në Shqipëri

Në datat 30 shtator – 2 tetor 2025, në Tiranë, u zhvillua një workshop tre-ditor i organizuar nga TAIX në bashkëpunim me ASIG, me qëllim mbështetjen e Shqipërisë në zbatimin e kuadrit ligjor të Infrastrukturës Kombëtare të të Dhënave Gjeohapësinore (NSDI) dhe përafrimin me Direktivën INSPIRE të Bashkimit Evropian.

Gjatë aktivitetit u prezantuan praktikat më të mira të vendeve anëtare të BE, procedurat për kontrollin e cilësisë, zbatimin e Direktivës për të Dhënat e Hapura, dhe shpërndarjen e të dhënave përmes API-ve të standardizuara. U trajtuan gjithashtu modelet ligjore dhe financiare për zbatimin e INSPIRE në Shqipëri, si dhe rëndësia e rritjes së kapaciteteve përmes trajnimeve.

Në përfundim, ekspertët e TAIX vlerësuan punën e ASIG në zhvillimin e Gjeoportalit Kombëtar dhe standardeve të përafruara me INSPIRE, si dhe rekomanduan masa konkrete për përmirësimin e cilësisë, harmonizimit dhe publikimit të të dhënave sipas praktikave më të mira evropiane.

ASIG merr pjesë në trajnimin e organizuar nga Joint Research Center (JRC)



Përfaqësues të ASIG morën pjesë në trajnimin e organizuar nga Joint Research Center (JRC) në datat 14–16 tetor 2025, në ambientet e Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural (AZHBR), me qëllim rritjen e kapaciteteve të stafit teknik të AZHBR në krijimin, mirëmbajtjen dhe menaxhimin e Sistemit të Identifikimit të Parcelave të Tokës (LPIS), si dhe në përdorimin e QGIS për digjitalizimin dhe interpretimin e të dhënave hapësinore.

Në vijim të këtij procesi, AZHBR do të implementojë një projekt pilot për ngritjen e sistemit LPIS në Qarkun e Beratit, i cili do të mbështetet në të dhënat gjeohapësinore të siguruar nga ASIG dhe të dhëna ndihmëse Open Source.

Në kuadër të bashkëpunimit ndër-institucional dhe në mbështetje të projektit, ASIG ka prodhuar ortofotot satelitore (2024–2025), shtresën e serrave bujqësore dhe shtresën pemëtoje për Qarkun e Beratit, të cilat do të shërbejnë si bazë për implementimin e sistemit LPIS.



ASIG merr pjesë në Workshop-in GovStack “Rritja e Kapaciteteve”

Në datat 20–22 tetor 2025, përfaqësues të ASIG morën pjesë në workshop-in e organizuar nga Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikacionit (ITU), në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në kuadër të projektit DART – Bujqësia Digjitale dhe Transformimi.

Aktiviteti i zhvilluar kishte në fokus rritjen e kapaciteteve institucionale për modernizimin e shërbimeve publike përmes qasjes ndërkombëtare GovStack.

Gjatë workshop-it u trajtuan konceptet e qeverisjes digjitale dhe përdorimi i moduleve “Building Blocks” për ndërtimin e shërbimeve publike të ndërveprueshme dhe të përqendruara te qytetari.

Diskutimet theksuan rëndësinë e standardizimit teknologjik dhe bashkëpunimit ndërinstitucional për zhvillimin e shërbimeve digjitale në Shqipëri.



BOTA E GJEONFORMACIONIT

Qipro drejt shndërrimit në qendër globale të Vëzhgimit të Tokës me projektin 38 mln €

Qipro po shndërrohet në qendër të Vëzhgimit të Tokës me një projekt evropian prej 38 milionë €, ku në Limassol hapet Qendra e Ekselencës “ERATOSTHENES” e Universitetit të Teknologjisë së Qipros. Projekti financohet nga Horizon Europe, EXCELSIOR (15 milionë €), Qeveria e Qipros (15 milionë €) dhe TEPAK (8 milionë €), duke sjellë një antenë satelitore 3,9 milionë € me akses në kohë reale dhe stacionin më të avancuar atmosferik për monitorimin e klimës, zjarreve, përmbajtjeve dhe bregdetit. Kjo qendër angazhon mbi 120 profesionistë dhe do të promovohet në fushatën evropiane Science4EU, duke forcuar shërbimet gjeohapësinore dhe vendimmarrjen publike.

INTERGEO 2025 vendos gjeoinformacionin në zemër të vendimmarrjes

INTERGEO 2025 u zhvillua më 7–9 tetor 2025 në Frankfurt, të Gjermanisë, duke theksuar inteligjencën artificiale gjeohapësinore, binjakët dixhitalë 3D, kapjen e realitetit dhe integrimin e Modelimit të Informacionit të Ndërtimit me Sistemet e Informacionit Gjeografik. Panairi mbledhi 18.500 vizitorë nga 119 vende, 530 ekspozues dhe mbi 1.200 pjesëmarrës në konferencë, me demonstrime të sensorëve të avancuar dhe analizave në kohë reale. Mesazhi kyç i aktivitetit është se ndërveprueshmëria, standardet e hapura dhe verifikimi i cilësisë së të dhënave përbëjnë parakushte për shërbime gjeohapësinore të besueshme dhe të shkallëzueshme.

AKTIVITETE NË VIJIM

ESRI SUMMIT 2025

Nga data 18–20 nëntor 2025, në Frankfurt, të Gjermanisë, do të zhvillohet Esri European Developer & Technology Summit, një aktivitet i fokusuar në inovacionet dhe aplikimet e teknologjisë gjeohapësinore (GIS). Konferenca përfshin sesione teknike dhe diskutime mbi zgjidhje të avancuara GIS, duke mbështetur krijimin e sistemeve të qëndrueshme, të sigurta dhe efikase për menaxhimin e të dhënave gjeohapësinore.

18- 20 Nëntor 2025

SDQ Conference

EuroGeographics dhe EuroSDR organizojnë nga 20-21 nëntor 2025, në Athinë, të Greqisë, Konferencën për Cilësinë e të Dhënave Gjeohapësinore. Aktiviteti do të mbledhë ekspertë të fushës për të diskutuar zhvillimet më të fundit mbi saktësinë, sigurinë dhe ndërveprueshmërinë e të dhënave gjeohapësinore, si dhe përdorimin e tyre në monitorimin mjedisor, qytetet inteligjente, menaxhimin e emergjencave dhe inteligjencën artificiale.

20 - 21 Nëntor 2025

SATELLITE SUMMIT 2025

Më 17–18 dhjetor 2025, në Amsterdam, të Hollandës, do të zhvillohet Samiti i 7 për Teknologjinë e Komunikimeve Satelitore dhe Hapësinore. Ky aktivitet ndërkombëtar do të shërbejë si forum kryesor për të eksploruar zhvillimet më të fundit dhe teknologjitë transformuese në sistemet satelitore, rrjetet hapësinore dhe ndërlidhjen globale, duke përfshirë dizajnin e satelitëve, integrimin 5G/6G, vëzhgimin e Tokës.

17-18 Dhjetor 2025

www.asig.gov.al

www.geoportal.asig.gov.al

Rruga Papa Gjon Pali II Nd. 2, H. 3, 1010, Tiranë;

Telefon: +355 (0)42 223 762;

E-mail: info@asig.gov.al